


ELEMENTET E



DEMOKRACISË

ZGJEDHJE TË LIRA DHE TË BARABARTA

ANISA (12), ASTRIT (12), BLERON (12), DION (12), GENTA (12), RION (12), VESA (13)



Zgjedhjet janë forma me demokratike për marrjen e pushtetit

Në artikullin tonë do të informoheni më shumë rreth zgjedhjeve. Çka janë zgjedhjet? Për çka na nevojten zgjidhjet? Zgjedhjet janë proces ku çdo qytetar i vendeve demokratike është lirë të marrë vendim për atë që dëshiron dhe që i duket më mirë për të. Këto lloj zgjedhje janë përditshmëri që i hasim çdo kund.

Ne si nxënës të klasës VII-2 i zhvillojmë disa zgjedhje siç janë: zgjedhja e kryesisë së klasës. Do t'iu tregojmë më shumë për mënyrën se si zgjedhet kryetari i klasës. Si fillim i propozojmë tre nxënës për kryetar të klasës pastaj votojmë për atë që mendojmë që është më i miri për ne. Kjo mënyrë e votimit është mënyrë demokratike. Kosova ka dy lloje zgjedhesh: zgjedhje lokale (komunale), ku qytetarët e Kosovës votojnë për kryeta-

rin e komunës dhe asambleistët, të cilët kanë mandat 4 vjeçar, si dhe zgjedhjet qendrore (parlamentare) ku qytetarët e Kosovës i votojnë deputetët të cilët kanë po ashtu mandat 4 vjeçar.

Por, kush ka të drejtë t'i votoj këta kandidatë për deputetë të asamblesë?

Të drejtën për t'i votuar këta kandidatë qoftë për deputetë apo asambleistë, ka çdo qytetar mbi moshën 18 vjeçare sepse në këtë moshë e arrijmë edhe pjekurinë e duhur për ta marrë këtë vendim.

Ne do t'iu tregojmë një kuriozitet të cilin një anëtar i grupit tonë e ka lexuar: „Për një votë në vitin 2006, një parti në një shtet në Azinë Perëndimore nuk arriti të marrë pushtetin“ - na tregon ai. Nga kjo mund të kuptojmë se zgjedhjet janë shumë të rëndësishme për një shtet, si dhe vota e secilit ka vlerë.



Në këtë vizatim kemi paraqitur zgjedhjet e përditshmërisë



Grupi i cili ka shkruar artikullin për zgjedhjet

RESPEKTI NDAJ NJËRI-TJETRIT

MARGARITA (12), ARIANË (12), ELTON (12), LEONIT (12), OLT (12), UVEJS (12), LORENA (13), VALËZA (12)


Ne jemi nxënës të klasës VII-2 dhe vijojmë mësimet në shkollën „Emin Duraku“. Sof kemi vendosur të flasim për të drejtat e njeriut dhe për respektin ndaj njëri-tjetrit. Shpresojmë që do ta pëlqeni artikullin tonë

Diskutimi ynë filloi duke përmendur historinë e demokracisë. Historia e demokracisë filloi në kryeqytetin e Greqisë, në Athinë. Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke, më saktësisht nga fjala „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë udhëheqje. Dallojmë dy lloje të demokracisë, demokracinë direkte dhe demokracinë përfaqësuese. E kundërta e demokracisë është monarkia, që do të thotë udhëheqje e vetëm një personi. Në demokracinë direkte vendimet janë marrë në formë direkte, dhe nuk kanë marrë pjesë të varfërit e as gratë. Për këtë arsye dhe gjithashtu për shkak se me kohë popullsia e Athinës u rrit, është paraqitur nevoja për një demokraci tjetër. Ajo ishte demokracia përfaqësuese.


Demokracia përfaqësuese është formë e demokracisë ku populli zgjedh disa përfaqësues, të cilët përfaqësojnë vendin e tyre. E kjo formë e demokracisë është prezente edhe në shtetin tonë, Kosovën. Elementet më të rëndësishme të demokracisë janë: liria e të folurit, shprehja e mendimeve, respekti ndaj njëri-tjetrit d.m.th të drejtat e barabarta pa dallim feje, race, gjinie apo prejardhje. Me këto të drejta ne si qytetarë të Kosovës kemi edhe përgjegjësitë tona. Kur shkojmë në shkollë përgjegjësia jonë është të mësojmë, të bëjmë detyrat, t'i ndihmojmë të tjerët, etj. Nëse ne i marrim përsipër këto përgjegjësi, atëherë ne mendojmë se demokracia jonë do të forcohet.



Gazetarët gjatë punës



Llojet e demokracisë të punuara nga ne




Disa nga elementet e demokracisë



Gazetarët e grupit që shkruajtën këtë artikull




Kutia e votimit




Disa prej gazetarëve duke punuar



Dioni duke vizatuar



Pema e degëzuar e demokracisë



Shtëpia e demokracisë



Vesa duke vizatuar për artikullin e grupit të saj




Disa prej gazetarëve duke diskutuar



Ilustrim i pastrimit të ambientit

KUVENDI - SHTËPIA JONË

FLORENT (12), MEDINA (12), ENIS (12), DIONA (12), JON (12), ALIJA (12), DRITA (12)



Ne i zhvilluam njohuritë tona për Kuvendin e Republikës së Kosovës duke hulumtuar

Sot pas një bisede lidhur me Kuvendin e Republikës së Kosovës, si një grup i gazetarëve të rinjë, po konstatojmë se Kuvendi i Kosovës është institucioni më demokratik. Pra, kryesisht ky institucion është i barabartë me popullin për nga të drejtat që i gëzojnë të dy palët. Megjithatë, meqë Kuvendi është institucion, ai ka rol të rëndësishëm. Kuvendi i Republikës së Kosovës, përbëhet nga 120 deputetë ose ndryshe nga 120 përfaqësues të popullit. Këta përfaqësues kanë profesione, mendime dhe dëshira të ndryshme për zhvillimin e vendit tonë.

Kuvendi me një fjalë quhet „Shtëpia e Popullit“. Shtëpia ku populli zgjedh të ardhmen e tij, dhe ku Kuvendi e realizon planin e qytetarëve të Kosovës.

Siç e përmendëm më lart, Kuvendi miraton ligje, por përveç kësaj Kuvendi ka edhe detyra tjera, si e zgjedh Presidentin dhe Qeverinë, mbikëqyr punën e Qeverisë dhe përfaqëson shtetin dhe popullin.

Kuvendi i ka edhe funksionet e veta të cilat janë: funksioni përfaqësues sepse përfaqëson popullin, funksioni legjislativ sepse miraton ligjet dhe funksioni i kontrollit sepse kontrollon Qeverinë.

Seancat plenare mbahen zakonisht ditëve të enjteve kurse mbledhjet e kryesisë mbahen zakonisht të hënave. 120 deputetë që janë në Kuvendin e Kosovës janë të zgjedhur nga populli, ku 100 nga deputetët

janë pjesëtarë të komunitetit shumicë, kurse 20 prej tyre janë pjesëtarë të komunitetit jo shumicë si për shembull: romë, ashkalinjë, egjiptianë, serb, etj. Qytetarë të dashur, shpresojmë që ky artikull do t'iu gjejë mirë dhe t'iu informoj më shumë rreth Kuvendit të Republikës së Kosovës.



Deputetja duke mbajtur fjalim



Autorët e artikullit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Emin Duraku“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë